

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, Kolegji i përbërë nga gjyqtaret Shqipe Qerimi Kryetare, Rasim Rasimi dhe Hashim Çollaku, anëtarë me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Jeton Leci, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.Z. nga fshati ..., Komuna e Istogut, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e të akuzuarit M.Z. , të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - dega në Istog, P.nr.21/17 të datës 04.09.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 26.10.2017, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e të akuzuarit M.Z. , kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - dega në Istog, P.nr.21/17 të datës 04.09.2017, **vërtetohet**.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë -dega në Istog , me aktgjykimin P.nr.21/17 të datës 04.09.2017, të akuzuarin M.Z. , e ka shpallur fajtor, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe për këtë vepër i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 200 (dyqind)€, të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi i tillë do të zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej 10 ditësh duke llogaritur 20 €, për çdo ditë e kaluar në burg.

I dëmtuari F.Z. është udhëzuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil.

Të akuzuarin gjykata e ka obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale ti paguajë Gjykatës , në emër të ekspertizës së komunikacionit shumën prej 50 € , në emër të ekspertizës mjeku – ligjore shumën prej 20 € , dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 € , të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi .

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar :

I akuzuari M.Z. , për shkak të vendimit për dënimin mbi sanksionin penal, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, në atë mënyrë që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i but sipas ligjit.

Prokurori i Apelit me parashtrësën PPA/II.nr.1168/2017, të datës 23.10.2017, ka propozuar që ankesa e të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet në ankesë në ankesë gjeti se:

### **Ankesa nuk është e bazuar.**

Aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi dhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP dhe gjeti se aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij dhe as shkelje të Ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase siç rezulton nga shkresat e lëndës i akuzuari e ka pranuar fajësinë, prandaj, sipas nenit 383 par 2 të KPP, ndaj aktgjykimin që është marr në bazë të pranimit të fajësisë, ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve.

Sa i përket vendimit për dënim në ankesën e të akuzuarit theksohet se dënimi është shumë i lartë dhe kërkoj nga gjykata që të ma lehtësoje dënimin e shqiptuar , sepse jam i pa punë , në gjendje jo të mirë ekonomike dhe jemi shumë anëtar në familje dhe një dënim i tillë është i papërbalueshëm duke përfshirë edhe ekspertizat dhe shpenzimet gjyqësore .

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimi i të akuzuarit për një dënim më të butë është i pabazuar. Gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit siç parashihet në dispozitën e nenit 73-74 të KPK. Kështu, si rrethana lehtësuese për të akuzuarin mori për bazë pranimin e fajësisë, se i njëjti kishte sjellje korrekte dhe nuk kishte rënë asnjëherë në konflikt me ligjin , është ndërë i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe ka shprehur keqardhje për veprën që e ka kryer , ndërsa rrethana rënduese Gjykata morri për bazë pasojën e shkaktuar me rastin e kryerjes së veprës penale .

Gjykata e Apelit vlerëson se pranimi i fajësisë së të akuzuarit për veprën e kryer dhe pendimi në raport me peshën e veprës së kryer ,nuk e arsyeton pretendimin e të akuzuarit për shqiptimin e një dënimi më të butë ngase në ankesën e të akuzuarit nuk ceket ndonjë rrethanë e re lehtësuese e cila nuk ka qenë objekt vlerësimi nga gjykata e shkallës së parë e cila do të ndikonte në shqiptimin e ndonjë dënimi më të butë. Kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i parashikuar me dispozitat përkatëse ligjore.

Nga kjo që u tha më lartë e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
PA1.nr. 1153/2017, me dt. 26.10.2017

Procesmbajtës  
Jeton Leci

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

1. Rasim Rasimi

Shqipe Qerimi

2. Hashim Çollaku